	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 1/3

PSB, 24.11.2021

Titulli i DPS/KT:

DPS/KT 55 “Stomatologji”

A Historiku

DPS/KT 55 është krijuar në 14.02.2002 në përputhje me Ligjin Nr. 9870 “Për Standardizimin”, i ndryshuar dhe rregulloret e brendshme të DPS në përputhje me rregulloret/udhëzuesit dhe strategjitë e CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbi krijimin dhe funksionimin e Komiteteve Teknike.

Fusha e këtij KT është adoptimi i standardeve evropiane dhe ndërkombëtare CEN/ISO si dhe hartimi i standardeve shqiptare lidhur me standardizimin e terminologjisë, metodat e testimit, specifikimet teknike për aparatet, pajisjet, materialet, dhe instrumentet të cilat përdoren në të gjitha degët e stomatologjisë.

B Mjedisi i biznesit

B.1 Të përgjithshme

Puna e DPS/KT 55 vazhdon me një ritëm të shpejtë për shkak të objektivit kryesor të këtij KT i cili është kontributi në zhvillimin e shëndetit publik duke zhvilluar dhe adoptuar standarde për pajisjet dentare. Në këtë mënyrë, pajtueshmëria dhe zbatimi i standardeve nga vetë prodhuesit në këtë fushë do të bënte të mundur që pajisjet mjekësore të përdorura në stomatologji të jenë të sigurt, me cilësi të lartë dhe të përshtatshme për përdorim. Ky komitet teknik nuk harton dhe adopton standarde për të përmbushur përparimet në fushën teknologjike, por i përgjigjet tregut ekzistues. Standardet e adoptuara nga ky KT janë të rëndësishme pasi shumë nga këto standarde përdoren për vlerësimin e konformitetit në pajisjet mjekësore të cilat përdoren në stomatologji.

B.2 Treguesit sasiore të mjedisit të biznesit

Përdoruesit e standardeve të adoptuara nga DPS/ KT 55 dhe palët e interesit të përfshira direkt në procesin e standardizimit brenda këtij KT janë vetë prodhuesit në këtë fushë, përfaqësuesit e drejtpërdrejta nëpërmjet shoqatave të konsumatorit, përfaqësuesit të subjekteve private dhe klinikave dentare në Shqipëri, organizmat certifikues, laboratorët e testimit, dhe studentët të cilët studiojnë në degën e stomatologjisë.

Standardet e adoptuara nga ky KT kanë përdorim të gjerë dhe synojnë

- përmirësimin e cilësisë së pajisjeve;
- kontrollin e prodhimit;
- sigurinë e cilësisë;
- përmirësimin e konkurrencës;
- ndihmën në globalizimin e ekonomisë të bazuar në konkurrencë;

C Përfitimet

Puna e DPS/KT 55 duhet të rezultojë në adoptimin e standardeve që do të mundësojnë:

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
	Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 2/3

- në ndihmën e prodhuesve në përmbushjen e kërkesave themelore për pajisjet dentare ;
- eliminimin e barrierave tregtare dhe favorizimin e tregut global;
- mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
- sigurimin e metodave të miratuara të testimit;
- promovimin e përmirësimit së cilësisë së produkteve në treg dhe në përmirësimin e cilësisë së kujdesit të ofruar tek pacientët.

D Pjesëmarrja në DPS/KT 55

Në DPS/KT 55 ka përfaqësues nga subjekte private, shoqata e konsumatorit, klinika dentare si dhe nga Universiteti *Albanian University*, i cili është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë, Licensuar në Prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i cili ofron studime të larta kryesisht në degën e stomatologjisë. Njëkohësisht, që në vitin e parë të krijimit të tij, ky institucion vuri në qendër të jetës akademike promovimin e produktit intelektual dhe shkrirjen e mësimit me kërkimin shkencor, e finalizuar me Konferencën e Parë Stomatologjike UFO Dental, e cila hapi siparin e një tradite tashmë të konsoliduar. Palët e interesuara në raste të veçanta për probleme specifike mund të emërojnë ekspertët e tyre në grupet e punës të ngritura nga KT për çështje specifike.

E Objektivat dhe strategjitë


E.1 Objektivat e përcaktuara nga DPS/ KT 55

- Një ndër objektivat kryesore të DPS/KT 55 është miratimi i standardeve, në përputhje me procedurat për hartimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare dhe dokumentet e tjera të standardizimit, për standardet e pajisjeve dentare të cilat përdoren në fushën e stomatologjisë dhe produkteve të tjera të cilat lidhen me to, rishikimin dhe, nëse është e nevojshme, përditësimin e standardeve SSH EN 1639 deri në standardin SSH EN 1642; të cilat mbulohen nga ky KT, duke përgatitur çdo vit programin e punës së KT;
- Përfaqësimi i interesave kombëtare në organizmat evropiane dhe ndërkombëtare kur ajo kërkohet;
- Aplikimi i parimeve themelore të standardizimit;
- Përgatitja dhe pasurimi me terma të reja të fushës i fjalorit terminologjik;
- Marrja në konsideratë e aspektit mjedisor kur ajo kërkohet sipas rasteve specifike;
- Bashkëpunimi i frytshëm me organizmat evropiane dhe ndërkombëtar si dhe në nivel rajonal;
- Marrja në konsideratë e ndikimeve dhe ndryshimeve të mundshme të një produkti ose pajisje në aspektin mjedisor.

E.2 Strategjitë e përcaktuara për arritjen e objektivave

Përmbushja e objektivave të DPS/KT 55 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 55	Stomatologji
ISO/TC 106	Stomatologji
ISO/TC 168	Protetikë dhe ortotikë

	Emri i institucionit: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT	Dokumenti Nr.: RC/DS/117	
Titulli: Plani strategjik i biznesit për DPS/KT	Versioni: 01	Faqe Nr.: Faqe 3/3	

F Planifikimi

Për realizimin e objektivave të më sipërme ky KT bazuar në propozimin e standardeve të reja fillon punën për adoptimin e standardeve.

G Financimi

Kryetari dhe anëtarët punojnë mbi baza vullnetare dhe pa pagesë.

Sekretari i DPS/KT 55

(Elona TELULI)